Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	**05.12.2023**	**22.12.2023**	**2023/0962**
Eksperti Teknik **Kreshnik Spahiu**	Data e autorizimit të ekspertit teknik **13.12.2023**		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 30.11.2023, OE "Eor Group SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0962, kundër njoftimit për kontratë, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me gjenerator per objektin e Komunes" me nr. të prokurimit: "636-23-6472-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E JUNIKUT.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 20,000.00 €.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Ne konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar LPP-në pasi qe nuk ka respektuar Nenet të LPP-së dhe RROUPP:

Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti paragrafi 1
Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca
Neni 62- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
Neni 65- Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 ,
Plotësimi i Aneksit Nr. 2 dhe 3 te Dosjes se Tenderit 2
Ku jepet sqarim se vertetimi i ATK-së dhe Gjykata kërkohen vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues
Shkeljet e dispozitave - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik

Kërkojmë nga PSH i OSHP-së të shqyrtojë ankesën tonë dhe të detyrojë Autoritetin Kontraktues të anulojë vendimin e dates 23.11.2023 duke e respektuar kërkesat e dhëna me FTD të dosjes se tenderit dhe bazuar në LPP-në, pasi qe në bazë të kerkesave të dhëna me FTD të dosjes se tenderit ne i plotsojmë të gjitha kerkesat e dhëna me DT, gjë qe deshmohet edhe me kërkesen e vertetimave të ATK-së dhe Gjykatës, mirpo pas dorzimit të vertetimave të ATK-së dhe Gjykatës edhe pse na u tha se do të shpallet njoftimi I vendimit qe shperblehemi me kontratë, sigurisht se kishte nderhyrje në komisionin e vlersimit për ta ndryshuar vendimin dhe nuk na shpallin fitues.

OE EOR GROUP SHPK kërkon nga PSH i OSHP-së që të detyrojë Autoritetin Kontraktues të veprojë bazuar në kërkesat e FTD të dosjes se tenderit dhe të nxjerr vendime të bazuara në LPP dhe në vlersimin e komisionit të pare kur na janë kerkuar vettetimat e ATK-së dhe gjykatës pasi qe n aka vlersuar të përgjegjëshëm. Kërkojmë që lënda të kthehet në rivlersim dhe AK-ja të shqyrtoj vendimin për eliminim nga tenderi i derguar me 23.11.2023 nga AK Komuna e Junikut pasi që është vendim i marrë në kundershtim me me nenin 1, 6, 7, 62 dhe 65 të LPP-së dhe Aneksit Nr. 2 dhe 3 te Dosjes se Tenderit 2.
Ku jepet sqarim se vertetimi i ATK-së dhe Gjykata kërkohen vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Prandaj kërkojmë nga PSH i OSHP-së të obligojë Autoritetin Kontraktues të respektojë RROUPP dhe LPP dhe të kthehet lënda në rivlersim, dhe duke respektuar FTD të dosjes se tenderit dhe Neni 1 Qëllimi, Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti paragrafi 1, Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca, Neni 62- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
Neni 65- Ligjit Nr. 04 L-042, pasi grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB COMPANY SHPK, është e pergjegjëshme dhe kemi ofertuar me çmimin me të lirë nga të gjithë OE-të, kërkojmë që të trajtohemi në menyrë jo-diskriminuese, kërkojmë që të detyrohet AK-ja, të shperblehet me kontratë OE EOR GROUP SHPK në këtë tender.

Kërkojmë nga PSH I OSHP-së të detyrojë Autoritetin Kontraktues të kthej lënden në ri vlersim, të anuloi vendimin e dates 23.11.2023, duke e respektuar kërkesat e dhëna me FTD të dosjes se tenderit dhe bazuar në LPP-në ,pasi qe në bazë të kerkesave të FTD të dosjes se tenderit dhe letres standarde të Autoritetit Kontraktues të dates 08.09.2023 ku Autoriteti Kontraktues I kërkon nga grupi I OE-ve per të sjell vertetimat per OE-të: EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK, bazuar në nenin 6.4 të FTD, le të kuptohet se grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK është i përgjegjëshem dhe vlersuar pozitivisht nga komisioni i vlersimit të Autoritetit Kontraktues.

Kërkesat e përshtatshmërisë	6.4	Përveç deklarates se shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2, dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet

Komisioni i vlersimit të Autoritetit Kontraktues me letren standarde të dates 08.09.2023 ka kërkuar dokumentet e përshtatshmëris Neni 6.4 i FTD të dosjes se tenderit dhe grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK i kemi ngarkuar në e-prokurim dhe i kemi derguar në formë fizike në zyren e Prokurimit të Komuna e Junikut, bazuar në vlersimin e komisionit të Autoritetit Kontraktues dhe letres standarde të dates 08.09.2023 jemi të përgjegjëshem sispas kushteve të dhëna në FTD të dosjes se tenderit prandaj komisioni i Autoritetit Kontraktues i ka kërkuar këto dokumente (vertetimat e ATK-së, Gjykatës dhe sigurimin e ofertës).

Grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB COMPANY SHPK bazuar në vlersimin e komisionit të Autoritetit Kontraktues dhe letres standarde të dates 08.09.2023 është i përgjegjëshem dhe një herit kemi çmimin me të lirë të ofertës dhe i plotsojmë të gjitha kerkesat e dhëna me DT.

FAKTI 1

Bazuar në kërkesat e dhëna me Neni 6.4 të FTD të dosja e tenderit dhe në Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , Plotësimi i Aneksit Nr. 2 dhe 3 te Dosjes se Tenderit 2.

Do të kërkohet: vertetimi i ATK-së dhe Gjykata vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Kërkesat e përshtatshmërisë	6.4	Përveç deklaratës se shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2, dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet Dokumentet të cilat do të kërkohen si dëshmi për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë janë me si vijon: a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. b. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (kontributi i sigurimit social), i dhe k] certifikate e lëshuar nga autoriteti kompetent apo operatori publik që një situatë e tillë nuk ekziston. c. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimi)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është debitorë (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit *[para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]* Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme.	
		Kërkesat e përshtatshmërisë: **1. Deklaratën nën betim se**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. Deklaratën nën betim se**

BIS_Dosja e Tenderit – Furnizim-Prokurim e Hapur 12

Me datë 08.09.2023 Autoriteti Kontraktues na ka derguar letër standarde për sqarimin e tenderit ku janë kërkuar dëshmitë e përshtatëshmerisë si në vijim:

Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit

KOMUNA E JUNIKUT, Qendër 51050 Junik

Date: 08.09.2023

Grup i Operatorëve Ekonomik Eor Group SH.P.K.; NH COMPANY SH.P.K., Dëshmorët e Panorbecit, 10000, PRISHTINË, Kosovë

Nr. i prokurimit:	636-23-6472-1-2-1
Nr i brendshëm	636-23-024-121

Titulli: Furnizim me gjenerator për objektin e Komunës

E nderuar, Shpresa Veliu!

Falënderërit që merrni pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Për të vlerësuar ofertën tuaj të përgjegjshme, ne kërkojmë që të siguroni dëshmitë e përshtatshmërisë si në vijim:

2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit - kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dëshmia se kompania nuk është në falimentim me një administrim te dhunshëm gjyqësore të lëshuar nga Gjykata - kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dëshmia i Operatorit Ekonomik që është propozuar të shpërblehet me kontratë të sjellë dokumentet e kërkuara në pikën 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj dhe të vazhdoj me shpërblim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është renditur në vendin e dytë e kështu me radhë.

3. Vërtetimi mbi pagesën e tatimit në pronë

Si dëshmi operatori ekonomik duhet të ofrojë Vërtetimin mbi pagesën e tatimit në pronë- kërkohet vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dëshmia i Operatorit Ekonomik që është propozuar të shpërblehet me kontratë të sjellë dokumentin e kërkuar i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj dhe të vazhdoj me shpërblim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është renditur në vendin e dytë e kështu me radhë.

Komisioni i vlerësimit të ofertave në përbërje prej tre zëvëndësve konform nenit 26.4. të Rregullores nr. 001/ 2022 për Prokurimin Publik në fuqi kërkon të ofrosi dëshmitë si me sipër: Vërtetimin e ATK- së dhe Vërtetimin nga Gjykata Ekonomike i Mungojnë dëshmitë për anëtarin e grupit.

Paraqitja me përgjigjet e juaja sqaruese duhet ti pranohen prej nesh **me shkrim** përmes sistemit elektronik E- brenda pesë (5) **dërëve** nga data e kësaj kërkese, **deri me datë: 13.09.2023 ora: 16:00**.

Pa përgjigjen nga ana e juaj me pyetjet e larta shënuara brenda afatit kohor të lartë shënuar, tenderi i juaj do të refuzohet.

Ju falënderojmë paraprakisht! Me respekt: Floriada Kokalaj!

Shënim:Dokument i bashkangjitur në shtojcën e dokumenteve

Me datë 11.09.2023 kemi provuar të kontaktojmë në Nr. të telefonit qe gjindet në dosjen e tenderit mirpo ne telefon nuk është paraqitur askush edhe pse kemi tentuar të kontaktojmë Autoritetin Kontraktues, atëhere në pa mundësi të komunikimit me telefon ju kemi derguar e-mailin me pytje se a mundemi vetem ti ngarkojmë në e prokurim dokumentet e kërkuara me letren standarde të dates 08.09.2023, qe pastaj të sjellim dokumentat në formë fizike kur të vijë afati për nenshkrim të kontrates.

Shënim:Dokument i bashkangjitur në shtojcën e dokumenteve

Autoriteti Kontraktues e ka dhënë këtë pergjigjje nga e cila nuk e kemi kuptuar se a mjafton vetem të ngarkohen ne e-prokurim apo duhet të dergohen fizikisht, në vazhdim pergjigjja në e-mail nga Autoriteti Kontraktues:



Shënim:Dokument i bashkangjitur në shtojcën e dokumenteve

Me daten 12.09.2023 i kemi ngarkuar ne faqen e prokurim: https://e-prokurimi.rks-gov.net/ dhe i kemi derguar fizikisht të Autoriteti Kontraktues në zyren e prokurimit në Junik të znj. Florinda Kukalaj.

Znj. Florinda Kukalaj pas verifikimit të vertetimave na ka thënë se çdo gjë është ne rregull dhe Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues qe jeni shperblyer me kontratë do të shpallet sot ose me se largu deri neser (me date: 12 apo 13.09.2023 do të shpallet Njoftimi I Vendimit ku shperblehemi me kontratë pas dorzimit të dokumentave AK me një vones prej 17 ditëve ndryshon vlersimin dhe fjalet e znj Florinda Kukalaj ku me 29.09.2023 shpall njoftimin për vendimin e AK-së ku ka shperblyer një OE tjeter e jo OE EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK).

KONKLUZIONI 1:

Autoriteti Kontraktues me Njoftimin e dates 29.09.2023, nuk e shperblen grupin e OE EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK por ka shperblyer me kontratë OKTA Electronic SHPK që është krejtë e kundërt me atë që na është thënë nga znj Florinda Kukalaj me daten 12.09.2023 në zyren e prokurimit Komuna e Junikut, se vertetimat e dorzuar nga grupi i OE EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK janë në rregull dhe Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues qe ju shperblen me kontratë do të publikohet sot ose neser qe d.m.th (12 ose 13.09.2023)

Kosovës Juriik

RSS - NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Numri i prokurimit	636-23-6472-1-2-1
Numri i brendshëm	NR. 23-024-131

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pranimarës	Vlera totale e Çmimit total të pranuar
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik Eor Group SH.P.K., NB COMPANY SH.P.K., Ibërmovës e Poshtëme, 10000 PRISHTINË	14,000.00
2.	N.P.I. "Rigra" Lidhja e Prizrenit, 10000, Prishtinë	17,950.00
3.	OKTA Electronics SH.P.K., Ura Rotulës, pn, Prishtinë	19,200.00
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik BOA Consulting SH.P.K., "Arta Gruppe" Sh.p.k. Salihaj@Llesheni, p.n. 11196, Podujevë	17,500.00
5.	"INFINITI" SH.P.K., Ibërmovës e Kamës, 10000 PRISHTINË	19,000.00

Rezultati i dërgohet palës pranuese.

Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik, njofton me Kontratë Operatorin Ekonomik, OKTA Electronics SH.P.K. Ura Rotulës, pn, Prishtinë me vlerë totale si vërtetë prej 19,200.00€

Data: 29.09.2023

Emri dhe mbiemri i ZTP

Nënshkrimi i ZTP

RSS - NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Shënim:Dokument i bashkangjitur në shtojcën e dokumenteve

Bazuar në nenin 6.4 të FTD të dosjes se tenderit dhe Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042, Plotësimi i Aneksit Nr. 2 dhe 3 te Dosjes se Tenderit 2.

Vertetimat e ATK-së dhe Gjykata kërkohen vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues

Me këtë rast Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar vertetimat nga grupi i OE EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK që d.m.th se komisioni ka vlersuar dhe konstatuar qe OE EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK janë të përgjegjëshem dhe OE EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK i ka dorzuar edhe vertetimat e ATK-së dhe Gjykatës dhe nuk jemi shperblyer me kontratë Autoriteti

Kontraktues ka shkelur Neni 6.4 të FTD të dosjes se tenderit, Neni 65 të LPP-së dhe UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK dhe kërkesat e FTD-së të dosjes se tenderit Kërkesat e përshtatshmërisë i parasheh LPP dhe i ka dhënë edhe vetë AK-ja në FTD të dosjes se tenderit:

FAKTI 2.

Komisioni vlersues i Autoritetit Kontraktues na është derjtuar dy here me letra standarde për sqarim të tenderit, si në vijim:

25.08.2023 15:15 B47 Leter Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit LS PER INFO SHTESE.pdf-

28.08.2023 **Grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK është pergjigjur**

05.09.2023 14:32 B47 Leter Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit LS PER INFORMATA SHTESE.pdf

07.09.2023 **Grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK është pergjigjur**

Komisioni i vlersimit i Autoritetit Kontraktues pas pranimit të përgjigjjeve nga grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK ka vertetuar se gjeneratori i ofruar me ofertë i plotsonë kërkesat e dhëna me Aneksin 1 të dosjes se tenderit dhe ky grup i plotsonë të gjitha kërkesat e dhëna sipas FTD-së dhe bazuar në nenin 6.4 të FTD të dosjes se tenderit dhe pergjigjje e letrave standarde komisioni i vlersimit i Autoritetit Kontraktues ka kërkuar vertetimat me lerten standarde të dates: 08.09.2023.

KONKLUZIONI 2.

Komisioni vlersues i Autoritetit Kontraktues bazuar në dokumentet e ofruara me ofertë dhe pergjigjëjet në letrat standarde ka vlersuar se oferta e dhënë nga grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK është e pergjegjëshem dhe i plotson të gjitha kërkesat FTD-së dhe kemi ofruar çmimin me të lirë, prandaj bazuar në dokumentet e prezantuara dhe neni 6.4 i FTD

të dosjes se tenderit komisioni i vlersimit ka derguar letren standarde me 08.09.2023 ku ka kërkuar dokumentet e pranueshmërise, pasi qe komisioni kishte vlersuar se oferta është e përgjegjëshme dhe në pajtushmeri me kërkesat e FTD të dosjes se tenderit dhe na kishte propozuar për të na shperblyer me kontratë. Prandaj kërkojmë që ky vlersim të mbetet në fuqi dhe të shperblehemi me kontratë, bazuar në këtë vlersim të komisionit edhe kemi dorzuar edhe vertetimat e ATK-së, Gjykates dhe sigurimin e ofertës, Autoriteti Kontraktues duhet të shperblejë me kontratë grupin e OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK

FAKTI 3.

Duke marrë për bazë neni 6.4 të FTD të dosjes se tenderit:

Kërkesat e përshtatshmërisë	6.4	Përveç deklaratës se shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2, dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do te kërkohen nga tenderuesi te cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet te dorëzohen nga tenderuesi para dhënies se kontratës. Në rast te dënimit te dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do te refuzohet

Autoriteti Kontraktues i kërkonë vertetimin e ATK-së dhe Gjykatës pasi qe komisioni i vlersimit ka konstatuar qe grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK janë të përgjegjëshem dhe i plotsojnë të gjitha kërkesat e dhëna me FTD të dosjes se tenderit.

Komisioni vlersues e ka vertetuar se grupi i OE EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK i kanë plotsuar të gjitha kërkesat e dhëna me Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË Tenderit (FTD) dhe ka mbetur vetem edhe kërkesat e pranueshmërise prandaj na është derguar Letra standarde me 08.09.2023 ku janë kërkuar nga AK-ja vertetimat e ATK-së dhe Gjykatës. Këto dokumente po e ri potencojmë se i kemi ngarkuar në e-prokurim me daten 12.08.2023 dhe një herit i kemi dorzuar fizikisht në zyren e prokurimit Komuna e Junikut

KONKLUZION 3.

Duke marr për bazë faktet e lartë cekura (FAKTI 3) , na dyshojmë se këtu individ apo grup i individve nga Autoriteti Kontraktues për interesa personale apo interesa të grupit ka ndërhyrë dhe kanë ndikuar të antarët e komisionit në vlersimin e komisionit, nën ndikim apo presione janë detyruar antarët e komisionit për ta ndryshuar vlersimin e komisionit që është bër deri me daten 12.09.2023, këtë dyshim e bazojmë në faktin se komisioni ka kërkuar dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise nga grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK që kërkohen nga tenderuesi të cilin autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën, mirpo pastaj ky grup nuk është shperblyer me kontratë edhe pse i ka ngarkuar në e prokurim dhe i ka derguar në zyren e prokurimit Komuna e Junikut dokumentet e kërkuara.

FAKTI IV

Kur Autoriteti Kontraktues me vendimin e dates 29.09.2023 nuk na ka shperblyer me kontratë me datë 05.10.2023 kemi derguar kërkesen për **Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues**

Autoritei Kontraktues me datë 06.10.2023 jep Përgjigjen në Kërkesen për Rishqyrtim dhe thotë: **Aprovohet pjesërisht kërkesa për Rishqyrtim**

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Junikut
Opština Junik - Municipality of Junik

KOMUNA E JUNIKUT
Zyra e Prokurimit

Z. Udhëheqësit të Prokurimit i Komunës së Junikut në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, në bazë të nenit 8, paragrafi 8.1.2 të Rregullave për parashtrimin e ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik si dhe në bazë të Kërkesës për Rishqyrtimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK nga OE **EOR GROUP SHPK** me seli në Prishtinë, të datës: 04.10.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Sinjalizimi vertikal dhe horizontal në Komunën e Junikut, Zyra e Prokurimit mori këtë:

VENDIM

I. Aprovohet pjesërisht kërkesa për Rishqyrtimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK nga EOR GROUP SH.P.K me seli në Prishtinë, të datës: 04.10.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me gjenerator për objektin e Komunës, **me numër të prokurimit: 636-23-6472-1-2-1 dhe me numër të brendshëm të prokurimit: 636-23-024-121**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues- Komuna Junik të publikuar me datën: 29.09.2023 në platformën elektronike E- Prokurimi.

II. Anulohet Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues- Komuna Junik të publikuar me datën: 29.09.2023 në platformën elektronike E-Prokurimi, lënda kthehet në Ri- vlerësim.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike E- Prokurimi.

Shënim:Dokument i bashkëngjitur në shtojcën e dokumenteve

Pas këti vendimi të kërkese për rishqyrtim të Autoritetit Kontraktues kemi besuar se Autoriteti Kontraktues do të përmirsojë shkeljen e dispozitave të LPP-së në vendimin 29.09.2023 dhe do të kthehej në piken ku do të shperblehet grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK me kontratë dhe në asnjë moment nuk kemi besuar qe Autoriteti Kontraktues qe do të vazhdojë me shkelje të rënda të dispozitave të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues në vendë që pas kërkese për rishqyrtim pasi që kërkesa aprovohet e bazuar të kthej lënden në piken kur OE EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK ju kanë kërkuar Vertetimi i ATK-së dhe vertetimi nga gjykata, të cilat dokumente i kemi ngarkuar në e-prokurim dhe i kemi derguar fizikisht dhe të shpallet nga AK-ja njoftimi i vendimit ku shperblehet grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB BETON SHPK. Autoriteti Kontraktues (individ apo grup i individve nga AK-ja) duke mos arritur synimin për të favorizuar ndonjë OE tjeter ku ka interesa të individve apo grupi të individve, me datë 01.11.2023 na dergonë Leter Standarde për informata shtesë.

Informatat e kërkuara me këtë Leter standarde të dates 01.11.2023 ishin të njejtat Informata qe Autoriteti Kontraktues i kishte kërkuar me Letren standarde për sqarim me datë 05.09.2023.

OE EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK është pergjigjur në këtë leter standarde të dates 01.11.2023 dhe ju kemi treguar se jemi përgjigjur në këto informata me pergjigjen e derguar me datë 07.09.2023. Mirpo krejt këtë veprim të Autoritetit Kontraktues e kemi kuptuar se ku është qellimi i AK-së, pasi që individ apo grup i individve që kanë interesa personale nuk kanë arritur të OE të cilen dojnë të favorizojnë, kinse po kërkojmë informata sqaruese (informata te cilat ju kemi përgjigjur në LS të dates 05.09.2023) dhe po gjejnë arsye për të eliminuar OE EOR GROUP SHPK & NB BETON SHPK.

KONKLUZION 4

Ky veprim i individve apo grupi të individve është veper penale, pasi qe në kërkesen për rishqyrtim kur e kemi derguar me daten 04.10.2023 ju kemi treguar se bazuar në momentin kur kërkohen vertetimi i ATK-së dhe vertetimi i gjykatës, OE është e përgjegjëshme. Dhe çdo ndryshim i këtij vendimi kuprohet se po bëhet për interesa të individve apo grupi të individve e ky veprim është veper penale. Dhe në qoftë se lenda nuk kthehet sipas vlersimit te komisionit i cili na ka shpallur të përgjegjëshem dhe në bazë të ketij vlersimi janë kërkuar edhe dokumentet ATK-së dhe gjykatës ne do të vazhdojmë me ankesë në të gjtha instutucionet e drejtsisësi në: Prokurori dhe Polici për Krime Ekonomike.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur neni 62 paragrafi 2 dhe 2.1 pasi qe grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK është i përgjegjëshem dhe brenda buxhetit të Autoritetit Kontraktues, (gjithmonë duke u thirrë në faktin se na është kërkuar të përmbushim kërkesat e përshtatshmëris vertetimi i ATK-së dhe Gjykatës) pra komisioni i vlersimit (komisioni i parë konsiderojmë qe nuk ishte i ndikuar nga interesat e individve apo grupit të individve) prandaj ka vlersuar drejtë dhe i ka shpallur të përgjegjëshem OE EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK në këtë rast, bazuar në faktet e prezantuara Autoriteti Kontraktues bën shkelje të rëndë, kur e nderpret aktivitetin, pra Autoriteti Kontraktues bazuar në neni 62 paragrafi 2dhe 2.1 nuk mundë të përfundoi aktivitetin.

KONKLUZION 5

Deri sa komisioni i vlersimit nuk kishte ndikim nga individ apo grup i individve të interesit për këtë aktivitet, OE EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK është vlersuar grup i OE-ve i përgjegjëshem, Autoriteti Kontraktues i kërkon dokumentet e përshtatëshmerisë dhe grupi i OE-ve i ngarkon këto dokumente në e-prokurim dhe i dergohn edhe në formë fizike të AK-ja, dokumentet e përshtatmërisë vertetimi i ATK-së dhe vertetimi i gjykatës, pas dorzimit në formë fizike dokumentet të AK-ja, nga Znj. Florinda Kukalaj na premtohet se: sot ose me se largu neser me datë 13.09.2023 do të shpallet njoftimi i vendimit ku shperblehet me kontratë OE EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK, mirpo kjo nuk ndodhi, dhe nga ky moment besojmë se me të kuptuar individ apo grup i individve se nuk është propozuar OE të cilen kanë interesa personale, kanë ndikuar në vendimin e komisionit qe e ka propozuar OE EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK të përgjegjëshem dhe e kanë detyruar komisionin e vlersimit për të ndryshuar vlersimin dhe kanë filluar të shfaqen interesat e individve apo grupi të individve nga AK-ja për të favorizuar ndonje OE tjeter (shih Njoftimin e dates 29.09.2023 dhe ndryshimi i çmimit të OE EOR GROUP SHPK & NB Company dhe OE të shpallur fitues, kjo jep arsyet me se miri pse ndryshohet vlersimi i komisionit i deri dates 12.09.2023).

Kërkojmë nga PSH i OSHP-së të detyrojë Autoritetin Kontraktues të **anuloj vendimin e dates 16.11.2023** dhe të kthehet lëndea në ri vlersim ku do të **shperblehet me kontratë** grupi i **OE EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK** sipas vlersimit të komisionit i cili ka kërkuar dokumentat e pranueshmërise Vertetimat e ATK-së, Gykatës dhe sigurimin e ofertës.

Kërkojmë nga PSH i OSHP-së të detyroj Autoritetin Kontraktues të kthejë lënden në ri vlersim, lënda të kthehet në piken ku ishte me 12.09.2023, në bazë të vlersimin e komisionit (12.09.2023), para nderhyrjes se individve apo grupit te individve, kërkojmë të merret për bazë

vlersimi i komisonit që ka konstatuar se grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK është i përgjegjëshem dhe plotsonë të gjitha kërkesat e dhëna me FTD dhe bazuar në këtë vlersim na është derguar letra standarde me 08.09.2023 ku janë kërkuar vertetimat e ATK-së, Gjykates dhe sigurimi i ofertës dhe ky grup i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK të shperblehet me kontratë.

Kërkojmë që për ndërhyrjet në komisionin e vlersimit të parë që janë bërë të informohen të gjitha Instutucionet e Drejtsisë në Republiken e Kosovës, të njoftohet POLICIA PËR KRIME EKONOMIKE , PROKURORIA E SHTETIT DHE MEDIAT sepse ka shumë elemente të interesit, ndikimit apo presionit ndaj antarve të komisionit të vlersimit për të ndryshuar vlersimin fillestar dhe për të favorizuar ndonje OE apo individ/ grup të individve në këtë tender.

OE EOR GROUP SHPK ka me shumë se 7 vite qe merrem me prokurim me të gjitha Autoritetet Kontraktuese të Republikes se Kosovës dhe nga të gjitha këto Autoritete Kontraktuese kemi vetem referenca pozitive. Deri me tani nuk ka ndhodhë asnjë here qe pasi të kërkohen vertetimat e ATK-së dhe gjykates dhe jemi në pajtushmeri dhe përshtatëshmeri me kërkesat e FTD të dosjes se tenderit të ndryshohet vendimi qe mos të shperblehemi me kontratë.

Deri me tani nuk ka ndodhë, as nuk kemi degjuar në asnjë rast kur Autoriteti Kontraktues pas kërkeses të derguar të OE për dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise dhe OE të dorzojë këto dëshmi siç parashihen me ligj, të ndryshohet vlersimi i komisionit vlersues i Autoritetit Kontraktues dhe të shperblehet me kontratë një OE tjeter **apo pas kërkeses për rishqyrtim kur kërkesa është e bazuar të ANULOI (nderprej aktivitetin), ky veprim vetem sa e konfirmon se në këtë aktivitet ka ndikime në komisionin e vlersimit të parë, është rasti i parë qe ndodhë të ndryshohet vlersimi i kmisionit vlersues i Autoritetit Kontraktues nga ndikimet të "brendshme apo të jashtme" nuk e dimë se kush ka ndikuar mirpo nuk ka ndodhur as një here qe të ndërhyjë ndonjë individ apo grup i individve në vendimin e komisionit vlersues dhe ta ndryshojë vendimin për interesa personale apo interesa te grupit për ta favorizuar një OE me qellime përfitimi të individit apo grupit të individve si në këtë rast.**

Me njoftim mbi vendimin e AK-së të datës: 16.11.2023, kur AK-ja nuk arrinë të shperblej OE të cilen e favorizon edhe me keq përseri ben shkelje të rënd të nenit 62 paragrafi 2 dhe 2.1 kur e anulon tenderin, për deri sa OE EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK sipas vlersimit të komisionit fillestar është i përgjegjëshem.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues në këtë tender ngrisin shumë çështje që duhet sqaruar nga instutucionet e drejtsisë dhe lënë shumë pytje të hapura...

-Pse....?

-Kush...?

-Arsye...?

-Qellimi...?

Nga faktet e prezantuara arrijmë në konkluzion se Autoriteti Kontraktues kur ka marr vendimin mbi anulimin e aktivitetit, të dates 16.11.2023 ka vepruar në kundershtim nein 6.4 të FTD të

dosjes se tenderit, nenin 7, neni 62 dhe neni 65 të LPP-së si dhe UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK dhe ka ndikuar dhe detyruar të ndryshohet vlersimi i komisionit profesional duke u ndikuar nga individ apo grup i individve për interesa personale, bazuar në vlersimin te komisionit dhe duke konstatuar qe grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK i plotsonë të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit, ky komision i vlersimit ka derguar letren standarde ku ka kërkuar ti dergojmë vertetimat e ATK-së, Gjykatës dhe sigurimin e ofertës për të shperblyer me kontratë grupin e OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK, ku me 12.09.2023 i kemi derguar në zyren e prokurimit Komuna e Junikut dhe pas verifikimit të këtyre dokumentave nga znj. Florinda Kukalaj-*drejtor në Prokurim Komuna Junik, ka thënë* se: dokumentet e dorzuara janë në rregull, Njoftimi për dhënje të kontrates do të publikohet (sot ose neser, d.m.th datë 12 ose 13.09.2023) ku do të shperblehet me kontratë grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK (***dokumentet e ATK-së, gjykates, sigurimi të ngarkuara edhe në e-prokurim***) .

Mirpo duke ndërhyrë apo ndikuar në forma të ndryshme ndonjë individ apo grup i individve për interesa të caktuara personale me qëlim të favorizimit të një OE të caktuar ka ndikuar në komisionin e vlersimit duke e detyruar këtë komision të ndryshojë vlersimin te cilin e kishin deri me daten 12.09.2023, që ishte vlersim i bazuar në kërkesat e FTD të dosjes se tenderit, ku pas datës 12.09.2023 komision ka qenë i ndikuar nga individ apo grup i individve dhe e kanë detyruar komisionin e vlersimit të ndryshojnë vlersimin. AK-ja ka marr vendim në kundershtim me LPP-në dhe ka bër shkelje të rënda të neneve të lartë cekura të LPP-së si dhe UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, pas dates 12.09.2023 deri me 29.09.2023 ka nxjer një vlersim te ri qe ka qenë i ndikuar dhe për favor të ndonje individi apo grupi të individve me datë: 29.09.2023 është dhënë Njoftimi mbi vendim e Autoritetit Kontraktues, ku e shperblenë OE OKTA Electronic SHPK me kontratë. ***Me 04.10.2023*** kemi derguar ***kërkesen për rishqyrtim***, me daten 06.10.2023 Autoriteti Kontraktues e kthen pergjigjen në kërkesen për rishqyrtim: **Aprovohet pjesrisht e bazuar kërkesa.**

Pas vendimit të AK-së për kerkesen për rishqyrtim ku aprovohet e bazuar lënda kthehet në ri vlersim mirpo Autoriteti Kontraktues në vend të përmirsoj shkeljet të cilat i kishim kontestuar me kërkesen për ri shqyrtim vetem sa vazhdon të bëj shkelje të me tutjeshme të dispozitave të LPP-së. Autoriteti Kontraktues ne pa mundësi të arrij të OE ku kishte synime dhe interesa nga individ apo grup i individve, bën shkelje të rënd të dispozitave të LPP-së duke derguar Leter Standarde për informata sqaruese, ku kërkonte të njejten informatë sqaruese qe kishim dhënë sqarime për këto informata me 07.09.2023, AK-ja perseri na e dergon kërkesen për të njejtat informata, vetem e vetem kinse po gjenë arsye për eliminim të OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK, si ka mundësi deri sa nuk kishte ndikime në komision vlersues të jemi të përgjegjëshem kurse pas ndikimit të njejtat dokumente të mos jenë të përgjegjëshme.

Pretendimi i AK-së ku thuhet se kërkohet katalog dhe kinse OE nuk ka dorzuar Katalog nuk qendron pasi qe Katalogu përmban me pakë informata se specifikimet teknike, kurse speifikat teknike të paisjeve janë të dhënat detale për secile paisje (gjenerator) dhe këto të dhëna i vendos prodhuesi dhe OE nuk kanë të drejtë të nderhyjnë apo ndryshojë këto të dhëna, çdo ndryshim apo modifikim i tyre është veper penale.

Prandaj grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK ka ngarkuar me ofertë specifikimet teknike për gjenerator siç i ka dhënë prodhuesi dhe këto specifikime teknike janë të prodhuesit dhe përmbajnë të gjitha informatat e domosdoshme teknike për paisjen (gjeneratorin).

Specifikimi teknik për gjenerator i dhënë me ofertë nga OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK i ka të gjitha të dhënat e kërkuara me Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME të dhënë me dosjen e tenderit.

Me njoftim mbi vendimin e AK-së të datës: 16.11.2023, kur AK-ja nuk arrinë të shperblej OE të cilen e favorizon edhe me keq ben shkelje të rënd të nenit 62 paragrafi 2 dhe 2.1 kur e anulon tenderin, për deri sa OE EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK sipas vlersimit të komisionit fillestar është i përgjegjëshem.

Kërkojmë nga PSH i OSHP-së të detyrojë Autoritetin Kontraktues të anuloi vendimin e dates 16.11.2023 dhe të kthejë lënden në rishqyrtim.

Bazuar në faktet të paraqitura me lartë kërkojmë nga PSH i OSHP-së pas shqyrtimit të Ankesës dhe marrjes për bazë të fakteve të cekura nga ne, të marrë:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK lidhur me tenderin Furnizim me gjenerator për objektin e Komunës i iniciuar nga KOMUNA E JUNIKUT.

TË ANULOHET vendimi i Autoritetit Kontraktues KOMUNA E JUNIK për Njoftimin mbi Vendimin e AK e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Ri-vlerësimi të bëhet bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit e që realisht më pas do duhej që fitues te shpallej **grupi i OE-ve EOR GROUP SHPK & NB Company SHPK**

Sipas vlersimit të komisionit deri me date 12.09.2029, deri sa nuk ka pas nderhyrje, presione dhe ndikim mbi komisionin e vlersimit të Autoritetit Kontraktues, pasi qe bazuar në këtë vlersim të komisionit vlersues të Autoritetit Kontraktues, jemi grupi i OE-ve i përgjegjëshme me çmimin me të lirë dhe për këtë arsye nga komisioni i Autoritetit Kontraktues bazuar në nein 6.4 të FTD të dosjes se tenderit na është kërkuar të sjellim dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise (vertetimat e ATK-së, Gjykates dhe sigurimin e ofertës).

Shkelja e supozuar ka ndodhur nga Autoriteti Kontraktues dhe ka shkelur pa dashje apo me dashje dispozitat e LPP-së (Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës).

Bazuar në shkeljet e lartë cekura dhe faktet që posedojmë, ne do të vazhdojmë me procedurat ligjore, në të gjitha instancat që parashihen me ligj në Republikën e Kosovës.

KRITERET PËR VLERËSIM

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Specifikimet teknike të detyrueshme janë:

1	Porosia ,Transporti,Furnizimi dhe Montimi i gjeneratorit: SPECIFIKIMI TEKNIK -dizel motorri duhet te jete me origjiin nga Bashkimi EUROPIAN (EU) ose Amerikane -Gjenerator me kabine -Fuqia 132 kVA- 105 KW - Nr. i cilindrave: 4, governing, turbo charged inter cooled, sistemi I ftohjes ftohja e lëngshme: - Shpejtesia e motorit: 1500 rpm - Faktori fuqi 0.8 - Faktori i kompresimit 17,5 : 1 --Kapaciteti total i vajit 12,8 l -Kapaciteti i ftohësit të motorit 18,5 l - Konsumi i karburantit me ngarkesë 100% në modalitetin kryesor (l/orë) 25,8 -Certifikata e testimit EN 10204:2001 -Certifikatat ISO+CE -Garancioni 5 vite -Certifikat e garancionit	copë	1
	SPECIFIKIMI I ALTERNATORIT -Frekuenca: 50 Hz - Koncept brushless, 4 shtylla -Fazat 3 + n - Tensioni V-400/230; - Klasa e mbrojtjes H - Sistemi i ngacmimit Elektronik - Performanca 93 % - Mbrojtje IP23 - Disel motori duhet te jete me i prodhuar me origjiin EU ose Amerikane		
	DIMENSIONET DHE PESHA - Madhësia (gjatësi x gjerësi x lartësi) – 2700 x 1010 x 1370 mm - Pesha (kg) i hapur 1250 kg; i mbyllur 1650 kg - Niveli i zhurmës (në distancë prej 7 metrave): i hapur 82 db; i mbyllur 70 db		
3	Në llogari hynë edhe çmontimi i gjeneratorit ekzistues dhe montimi i gjeneratorit të ri me të gjitha paisjet shtesë si: kabllot për kyçje gjenerator- rrjet- objekt (kyçje automatike) siguresa, bateri (akumulator) dhe të gjitha materialet e nevojshme për montimin dhe funksionalizimin e gjeneratorit.	copë	1

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komuna Junik

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

Sipas Nenit 42.1 dhe 42.3 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik

Titulli: Furnizim me gjenerator për objektin e Komunës

Numri i prokurimit	636-23-6472-1-2-1	
Numri i brendshëm	636-23-024-121	
Nr.	**Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës**	**Vlera totale e Çmimit total të peshuar**
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik Eor Group SH.P.K.; NB COMPANY SH.P.K., Dëshmorët e Ponoshecit, 10000, PRISHTINË	14400.00
2.	N.P.T. " Bajra ", Lidhja e Prizrenit, 10.000, Prishtine	19990.00
3.	OKTA Electronics SH.P.K., Isa Boletini, pn, Prishtine	19200.00
4.	Grup i Operatorëve Ekonomik ROA Consulting SH.P.K.; „Auto Grezda Sh.p.k., Sallabajë-Lluzhan, p.n, 11050, Podujevë	15300.00
5.	" INFINITT " SH.P.K., Dëshmorët e Kombit, 10000, PRISHTINË	16830.00

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Autoritetit Kontraktues- Komuna Junik, bazuar në nenin 43, paragrafi 43.5 pika b) i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik anulon aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me gjenerator për objektin e Komunës.

Data: 16.11.2023
Emri dhe mbiemri i ZPP: Florinda Sutalaj
Nënshkrimi:

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
JUNIK

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Eor Group SH.P.K.**

Autoriteti Kontraktues -Komuna e Junikut, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës-furnizim. Vlera e parashikuar e kontratës 20,000.00 €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët.**

Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, përkatësisht kundër arsyetimit të eliminimit, ku AK përmes Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 16.11.2023 potencon se tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: *Pas vlerësimit të ofertës tuaj Autoriteti Kontraktues –Komuna Junik ka vërejtur te pika III.2.4 e Kapacitetit Teknik/ose Profesional, kriteri me nr.2 OE duhet te ofrojë katalog për Gjeneratorin ku duhet të përshkruajë dhe të përmbajë karakteristikat e Gjeneratroit siç kërkohet nga NJK në ANEKSIN nr. 1 të Dosjes së Tenderit ku si dështmi është kërkuar OE duhet të ofrojë katalogun me përshkrim siç kërkohet nga AK .***"***Operatori ekonomik nuk ka plotësuar kërkesën siç është kërkuar nga AK mirëpo si* ***dështmi keni ofruar një pjesë te katalogut në formën e specifikacionit por specifikacioni i dhe katalogu i ofruar nuk përputhet me specifikacion e AK- Komuna e Junikut."***

Eksperti shqyrtues/teknik i ka përmbledh në tre pika pretendimet e OE ankuesit "Eor Group" Sh.p.k & "NB Company" Sh.p.k

- Operatori ekonomik ankues pretendon se përderisa AK –Komuna e Junikut i ka kërkua përmes letrës standarde për sqarim të tenderit dokumente/dështmitë e përshtatshmërish si vërtetimin e ATK-së dhe të Gjykatës, ky ka qene fitues ketë e bazon në nenin 6.4 të FDT të dosjes se tenderit sepse këto dokumente kërkohen vetëm nga operatoret ekonomik qe propozohen për shpërblim të kontratës dhe dorëzohen tek AK para publikimit të njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, tutje OE ankues shton se edhe pse ne këto dokumente i kemi dorëzua na nuk jemi shpërblye me kontratë, po ashtu sipas ankuesit kur të njëjtat dokumente janë verifikuar nga zyra e prokurimit një zyrtare në ketë zyre ja konfirmon se çdo gjë është ne rregull dhe vendimi qe jeni shpërblye me kontrate do shpallet sot ose nesër, tutje OE ankues pretendon se në momenti që kërkon këto dokumente kemi qene fitues po pas 17 dite pritje nga fjalët e zyrtares ne nuk ishim fitues por një OE tjetër .

- Operatori ekonomik pretendon se ka pas ndërhyrje ndaj komisioni të vlerësimit të herës së parë dhe për interesa dhe përfitime na nuk jemi fitues, ku kjo është shkelje dhe përben vepër penal ku pretendon se duhet informohen të gjitha institucionet e drejtësisë sepse ka shumë elemente të interesit ndikimit dhe presionit ndaj anëtareve të komisionit të vlerësimit për të ndryshuar vlerësimin fillestar.

- Operatori ekonomik pretendon se nuk qëndron arsyeja e eliminimit lidhur me kërkesën për katalog e precizuar nga AK në njoftimin mbi vendimin të datës 16.11.2023.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Eor Group" Sh.p.k & "NB Company" Sh.p.k se AK - Komuna e Junikut, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së duke mos shpërblyer me kontratë OE ankues pasi ka kërkuar dorëzimin e dëshmive lidhur me kërkesat e përshtatshmërisë**. Eksperti shqyrtuese/teknik** sqaron se kërkesat nga AK për dorëzimin e dokumenteve të përshtatshmërisë nga OE ankues nuk do të thotë dhe nuk e obligon autoritetin kontraktues me asnjë dispozite ligjore të prokurimit publik që të njëjtin ta shpërblej me kontrate në raste kur dëshmohet se operatori ekonomik nuk ka dorëzuar ofertë sipas kushteve kërkesave, kritereve dhe specifikacionit teknik si në këtë raste që katalogu i dorëzuar nga OE që nuk është në pajtim me të gjitha specifikimet teknike të aneksit 1 të dosjes së tenderit. Andaj, vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve bëhet sipas kërkesave të vendosura në dosje të tenderit nenin 59, par. 4 të LPP-së, dispozitë e cila përcakton se autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë **është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit**.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Eor Group" Sh.p.k & "NB Company" Sh.p.k se për përfitime dhe interesa personale ka pas ndërhyrje ndaj komisioni të vlerësimit të herës së parë për të ndryshuar vlerësimin fillestar. **Eksperti shqyrtuese/teknik** konsideron se ky pretendim ankimor nuk ka të bëjë me çështje në të cilën mund të japim përgjigje sepse i gjithë vlerësimi i jonë duhet të bazohet në shkresa/prova dhe argumente për secilën përgjigje që japim por nëse OE ankues ka argumente apo konsideron se mund ti dëshmon këto pretendime mundë ti drejtohet organeve tjera kompetente.

Operatori ekonomik pretendon se nuk qëndron arsyeja e eliminimit lidhur me kërkesën për

katalog e precizuar nga AK në njoftimin mbi vendimin të datës 16.11.2023.

Rrethanat e çështjes

AK në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ka vendosur kërkesën tek kapaciteti teknik dhe profesional: 2.*OE duhet të ofrojë katalog për Gjeneratorin ku duhet të përshkruajë dhe të përmbajë karakteristikat e Gjeneratorit siç kërkohet nga NJK në ANEKSIN nr.1 të Dosjes së Tenderit*. Për këtë kërkesë, dëshmia e kërkuar dokumentare është përcaktuar: *2.Si dëshmi OE duhet të ofrojë katalogun me përshkrim siç kërkohet nga AK.*

Në tenderin e OE ankues është dorëzuar edhe dokumenti "*Katalogu_WIRMAN 150 KVA*". Në katalog janë paraqitur karakteristikat teknike të produktit Wirman 150 KVA.

OE ankues ka dorëzuar dokumentin "*Përgjigjeja e Letrës Standarde"* që mbanë datën 03.11.2023, në të cilin dokument ndër të tjera thuhet "*Gjeneratori WIRMAN WM-150 KVA DIESEL GENERATOR SET / 50Hz është i prodhuar në Turqi me standard EUROPIAN (EU), Turqia shtrihet në EUROPË dhe AZI, mirëpo për këtë arsye kemi bashkangjitur certifikaten CE për të treguar se prodhimi është konform standardit EUROPIAN (EU) dhe kërkesave të tenderit Aneksi 1. Bazuar në Neni 7 parag. 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik. Nuk ekziston as një vendim apo dokumentacion ku Qeveria e Republikes se Kooves ka venë ndonjë ndalesë apo sanksion për produketet apo prodhimet e Turqisë, prandaj bazuar në këto dispozita të LPP-së dhe vendimeve të Qeverisë, gjeneratori WIRMAN WM-150 KVA DIESEL GENERATOR SET / 50Hz i plotsonë kërkesen në Anex1 të dosjes se tenderit për deri sa posedon certifikaten CE. Bazuar në neni 7 paragrafi 2, në qoftë se AK e kufizonë kërkesen vetem në vendet e Bashkimit Europian (EU) dhe Amerikan në këtë rast do të shkelen dispozitat e LPP-së, pasi qe po redukton apo eliminon konkurrencën në mes të OE-ve. Sepse edhe pse janë prodhime nga Bashkimi EUROPIAN apo Amerikane shumica e prodhuesve I kanë fabrikat dhe prodhimet në KINË po prodhohen sipas standardit EUROPIAN (EU) qe konfirmohen me certifikat CE.Po ju ri bashkangjitemi edhe një here certi fikaten CE ku tregohet se*

gjeneratori WIRMAN WM-150 KVA DIESEL GENERATOR SET / 50Hz është I prodhuar sipas standardit EUROPIAN (EU)."

AK me datë 16.11.2023 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së përmes të cilit e anulon aktivitetin e prokurimit. Në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, AK ka dhënë arsyetimin për OE ankues si vijon: Pas vlerësimit te ofertës Autoriteti Kontraktues-Komuna e Junik ka vërejtur te pika III.2.4 e Kapacitetit Teknik/ ose Profesional, kriteri me nr.2.*OE duhet të ofrojë katalog për Gjeneratorin ku duhet të përshkruajë dhe të përmbajë karakteristikat e Gjeneratorit siç kërkohet nga NJK në ANEKSIN nr.1 të Dosjes së Tenderit* ku si dëshmi është kërkuar *2.Si dëshmi OE duhet të ofrojë katalogun me përshkrim siç kërkohet nga AK.*, operatori ekonomik nuk e ka plotësuar kërkesën siç është kërkuar nga AK mirëpo si dëshmi keni ofruar një pjesë të katalogut në formën e specifikacionit por specifikacioni dhe katalogu i ofruar nuk përputhet me specifikacionin e AK-Komuna Junik.

<u>Vlerësimi i ekspertit teknik</u>

Fillimisht, **eksperti teknik** sqaron se OE ankues ka dorëzuar katalogun për gjenerator me karakteristikat përkatëse, ashtu sikurse është sqaruar mësipër. **Eksperti** ka bërë krahasimin e të dhënave në katalog të produktit të ofertuar (*WIRMAN 150 KVA*) në raport me kërkesat e dosjes së tenderit dhe rezulton se për disa nga pozicione ka mospërputhje në mes të specifikave të dosjes së tenderit dhe atyre të produktit të ofertuar si dhe mungesë të informacioneve në katalog.

Fillimisht, pociziconi - madhësia e specifikuar në dosje është (gjatësi x gjerësi x lartësi) - 2700 x 1010 x 1370 mm, ndërsa produkti i ofertuar ka dimensionet 2850 x1080 x1600. Eksperti sqaron OE ankues sipas shkresave të lëndës nuk ka kontestuar specifikimin lidhur me dimensionet në fazën para dorëzimit të tenderit, rrjedhimisht duke dorëzuar ofertë e ka marrë si të mirëqenë këtë kërkesë të dosjes së tenderit.

Më tej në aneksin 1 të dosjes së tenderit, ndër të tjera është specifikuar kërkesa "performanca" - 93 % katalogun e dorëzuar nga OE ankues nuk ka informata në lidhje me performancën.

Në fund, në lidhje me kërkesën e specifikuar "*Disel motori duhet te jete me i prodhuar me*

origjinë EU ose Amerikane", në katalog nuk ka informata për origjinën e prodhuesit të motorit. Në lidhje me këtë pikë, ashtu sikurse është sqaruar mësipër, OE ankues gjatë sqarimeve në fazën e vlerësimit e konteston kërkesën për vendin e prodhimit si pretendim për kufizim gjeografik të panevojshëm. Në lidhje me këtë pikë, eksperti sqaron se OE ankues sipas shkresave të lëndës nuk ka kontestuar kërkesën lidhur me origjinën në fazën para dorëzimit të tenderit, rrjedhimisht duke dorëzuar ofertë e ka marrë si të mirëqenë këtë kërkesë të dosjes së tenderit të cilat janë duhet të plotësohen nga OE-të. Prandaj, sipas sqarimeve të dhëna me lartë, pretendimi ankimor në këtë pikë është i pabazuar duke qenë që OE ankues ka ofertuar me produktin i cili nuk është në pajtim me të gjitha specifikimet teknike të aneksit 1 të dosjes së tenderit.

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, eksperti shqyrtuese/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa vendimi i AK-së, të mbetet në fuqi për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E JUNIKUT**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Eor Group SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Majlinda Bedrolli

Kreshnik Spahiu